



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.434/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Diellzë Haxhimusa, kandidate për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Ferizaj, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për kuvend komunal në Ferizaj, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me **12.11.2025**, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET e pasafatshme ankesa ZL.Anr.434/2025, e datës 07.11.2025, e parashtruar nga Diellzë Haxhimusa, kandidate për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Ferizaj, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me Nr.01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për kuvend komunal në Ferizaj, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 11.11.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.434/2025, paraqitur përmes postës me datë 07.11.2025, nga Diellzë Haxhimusa, kandidate për anëtarë të kuvendit komunal, Komuna Ferizaj, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shpalljen e rezultateve përfundimtare për kuvend komunal në Ferizaj, në të cilën pretendon se në zgjedhjet lokale të mbajtura me datë 12.10.2025, ishte kandidate për kuvendin komunal në Ferizaj me nr. 36 në listën nga PDK. Familjarët e saj të afërt e kishin kanë votuar në shkollën “Jeta e Re” në fsh.Greme, në vendvotimet me numër 2514/01, 2514/03, 2514/04, 2514/05 dhe 2514/06, mirëpo në rastin e numërimit votat nuk ishin evidentuar. Pala ankuese kërkon nga PZAP të dërgojë në rinumërim vendvotimet e lartpërmendura.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve-KQZ, sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN),

Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Andaj pas analizimit të lëndës është vërejtur se pala ankuese ankesën e ka paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sepse pas konfirmimit të ZEKKZ në komunën e Ferizajt, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 16.10.2025, ndërsa pala ankesën e ka parashtruar me datën 07.11.2025. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në deklaratat e personave, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

Me tutje, KQZ sqaron se në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës pala ankuese nuk ka bashkangjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor gjendet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas vlerësimit të afateshmërisë së ankesës, gjeti se:

- ***Ankesa është e pasafatshme.***

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa e parashtruar Diellzë Haxhimusa, kandidate për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Ferizaj, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK, në të cilën pretendon se në zgjedhjet lokale të mbajtura me datë 12.10.2025, e kishin votuar Familjarët e saj të afërt të cilët kishin votuar në shkollën “Jeta e Re” në fsh.Greme, në vendvotimet me numër 2514/01, 2514/03, 2514/04, 2514/05 dhe 2514/06, është e parashtruar pas afatit të paraparë ligjor.

Me dispozitën ligjore të nenit 106 paragrafi 3 i LZP-së, i cili përcakton se: “*Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij, Ankesa vendoset nga PZAP brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj*”, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se “*PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor*”.

Në rastin konkret Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP me datë 11.11.2025, në të cilën pretendon se në zgjedhjet lokale të mbajtura me datë 12.10.2025, ishte kandidat për kuvendin komunal në Ferizaj me nr. 36 në listën nga PDK. Familjarët e saj të afërt e kishin votuar në shkollën “Jeta e Re” në fsh.Greme, në vendvotimet me numër 2514/01, 2514/03, 2514/04, 2514/05 dhe 2514/06, mirëpo në rastin e numërimit votat nuk ishin evidentuar, ndërsa nga të dhënat zyrtare nuk është kontestuese se shpallja e rezultateve përfundimtare është bërë me datën 03.11.2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesës nuk është paraqitur brenda afatit ligjor siç parashihet me nenin 106, paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, andaj dhe e njëjta u deshtë që të hedhet si e pasafatshme.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendimet e ankueses se ka parashtruar ankesë me email, ku pastaj edhe është udhëzuar që të parashtrojë ankesë me postë apo drejtpërdrejtë në PZAP, mirëpo të njëjtat pretendime janë të pa baza dhe nuk kanë pasur ndikim në vendosje ndryshe nga ana e PZAP-së, kjo për faktin se me dispozita ligjore nuk është e paraparë që ankesa të mund të parashtrohet përmes emailit, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 106 paragrafi 3, nenit 115 paragrafi 1, nenit 102 paragrafi 1 i LZIP-së Nr.08/L-228, dhe nenit 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 të Rregullores 01/2025, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosijs së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.434/2025, datë 12.11.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZIP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.